



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:263397  
Datë: 20.09.2024  
Numri i dokumentit: 06190220

**C.nr.3996/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Shaban Shala, me praktikanten gjyqësore E.D. në çështjen juridike të paditëses M.K. nga fshati Zym, Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokatja S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të ushqimit- shujtave ditore, me vlerë të kontestit 368,00 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, me datën 20.09.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**-pa shqyrtim kryesor të çështjes-**

**APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses **M.K.** nga fshati Zym, Komuna e Prizrenit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim ditor-shujtave për vitin 2021 dhe 2022, t'ia paguaj paditëses për 184 ditë pune brenda vitit 2021 dhe 2022 shumë prej **368,00 €** (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë (17.11.2023) e gjerë në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II. DETYROHET** e paditura që t'ia paguajë paditëses shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124,00 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësja M.K. nga fshati Zym, Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokatja S.M.N. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave - ushqimit gjatë punës, me vlerë të kontestit 368,00 €.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, më datë 18.03.2024 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe

kërkesëpadinë me arsyetim se palës paditëse nuk i takon kompensimi i shujtave pasi që është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe thekson që përfitues i beneficioneve që rrjedhin nga kjo kontratë janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa pala paditëse nuk ka paraqitur fakte se është anëtare e kësaj sindikate. E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se pala paditëse nuk i ka shtjerrur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative dhe se Ministria e Financave nuk ka kod të posaqëm buxhetor për këtë kategori të shpenzimeve.

Paditësja padisë i'a ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: kopjen e letërnjoftimit, kopjen e kontratës së punës të lidhur ndërmjetë M.K. si punëmarrëse dhe DKA në Prizren si punëdhënëse, vërtetimin për ditët e pranisë në punë për paditësen gjatë vitit 2021 dhe 2022 të lëshuar nga SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në Zym me numër të protokollit 186/23 të datës 13.11.2023, dhe autorizimin.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur, por mbetet kontestues fakti se paditëses a i takon kompensimi për ushqimin ditor, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditëses është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit nr. 01/B-105 të dt.22.01.2021 konkretisht me nenin 35.7 i cili rregullon të drejtën për shujtje-ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t'ia kompenzon ushqimin ditor në shumën më detalisht të vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke llogaritur një ditë pune nga 2 € për shkak se nga provat materiale konkretisht vërtetimi i lëshuar nga vet e paditura vërtetohet fakti se paditësja ka 184 ditë pune tek e paditura dhe për këto ditë pune i takon shpërblimi i ushqimit ditor (shujtës).

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 378 dhe 382 të LMD-së dhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse, ku gjykata ka pranuar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës datën e parashtrimit të padisë (17.11.2023) duke llogaritur kamatën prej 8 % në vit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124,00 € dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104,00 € dhe në emër të taksës për padi 20 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Numri i lëndës: 2023:263397

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06190220

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**-Departamenti i përgjithshëm-**

**C.nr.3996/23, dt. 20.09.2024**

**Praktikantja**  
**Erëza Danjoli**

**Gjyqtari**  
**Shaban Shala**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.